

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE "ANDI KONSTRUKSION" SH.P.K.

Ne Tirane, sot me date 25 Prill 1996 nentedhjeteeegjashte une Latif Miho i biri i Hidrit dhe i Nadires, i datelindjes 1964, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane ne Rrugen A.Moisiu. Pallati 40 Shkalla 15, Apartamenti 2, Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike, ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

**V E N D O S A :**

**NENI 1**

Te krijoje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te emeruar "Andi Konstruksion" Sh.P.K.Tirane.

**NENI 2**

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne Rrugen A.Moisiu. Pallati 40 Shkalla 15, Apartamenti 2, Tirane, ne banesen e krijuesit te shoqerise zotit Latif Miho.

**NENI 3**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :  
Te ushtroje veprimtari private ne sferen e ndertimit montimit e zbatimit per ndertimin e linjave te tensionit te larte dhe bulet, vepra arti, ura, rruge, vepra social-kulturore, pallate banimi, rikonstruksione objektesh ne veprat bonifikuese, ujesjellesa, kanalizime, vepra hidroteknike te te gjitha llojeve, prodhimin dhe tregtimin e materialeve te ndertimit, ne sferen e tregtimit te mallrave te ndryshme te importit dhe te eksportit me pakice dhe me shumice, mallra te tilla si ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, fruta, perime, bime medicinale e pajisje mjekesore, te bar bufe-restorantit, elektro shtepiake, per shfrytezimin dhe tregtimin e lendes drusore, per tregetimin dhe transportimin e karburanteve dhe te vajrave lubrifikante te te gjitha llojeve, kerkim-zbulimin, shfrytezimin dhe importimin e mineralit te kromit dhe produkteve te tij, mermereve, te mallrave te ndryshme etj.

**NENI 4**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte prone e ortakut te vetem te shoqerise, krijuesit te saj zotit Latif Miho.

**NENI 5**

Kohe-zgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet te njepasnjeshme. Por ajo mund t'a pushoje veprimtarine e saj





edhe perpara ketij afati ne rastet e parashikuara ne statutin e shoqerise.

**NENI 6**

Shoqeria "Andi Konstruksion" Sh.P.K. Tirane do te perfaqesohet nga ortaku i vetem i saj qe eshte njokohesisht edhe administratori i shoqerise zoti Latif Miho, si dhe nga personat e autorizuar prej tij.

**NENI 7**

Ndryshimet ne kete akt-themelimi do te behen ne te njejten menyre dhe procedure ne te cilen nxirret akt-themelimi.

Akt-themelimi nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SH.P.K. "ANDI KONSTRUKSION"  
LATIF MIHO**

*Latif Miho*  
*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR.REP. 1541

NR.KOL. 221

V E R T E T I M

Sot, me date 25 Prill 1996 (nëntëdhjetë e gjashtë) ditë e Enjte, në Dhomën e Noterisë në Tiranë, para meje noteres, u paraqit personelisht Latif Miho, biri i Hidrit, lindur më 18 shkurt 1964, me dhore, me notësi të plotë juridike për të vepruar, identiteti i të cilit mu bë i njohur në bazë të letërnjoftimit me Nr.42 357345 i cili deklaroi se kontstatën e themelimit të shoqërisë "Andi Konstruksion" shpk, e harton me vullnetin e tij të lirë dhe sipas ligjit e nënshkroi atë para meje noteres.

12. 07. 1996

N O T E R E

NOPERE  
LIDA KOKUSHTA  
TIRANE ALBANIA  
TEL. 295 49



*[Signature]*



**S T A T U T I**  
**I**  
**SHOQERISE "ANDI KONSTRUKSION" SH.P.K.**

**F O R M I M I**  
**NENI 1**

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar "Andi Konstruksion" Sh.P.K.Tirane me ortakun e saj te vetem zotin Latif Miho i biri i Hidrit dhe i Nadires, i datelindjes 1964, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane ne Rrugen A.Moisiu. Pallati 40 Shkalla 15, Apartamenti 2, Tirane me zotesi te plote juridike, me leternjoftimin personal Az.Nr.357345.

**S E L I A**  
**NENI 2**

Selia e shoqerise do te jete ne Rrugen "A.Moisiu" Pllati 40, Sh.15, Apartamenti 2, Tirane.

Shoqeria mund te hape edhe vend-qendrim te tjera te dyja operative, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te vendit ku ato hapen dhe me miratimin e organeve perkatese kopetente.

**KOHE-ZGJATJA**  
**NENI 3**

Kohe-zgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mi 10 vjet te njepasnjeshem. Por ajo mund ta pushoje veprimtarine e saj edhe perpara ketij afati ne rastet e parashikuara ne kete statut.

**O B J E K T I**  
**NENI 4**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :  
Te ushtroje veprimtari private ne sferen e ndertimit montimit e zbatimit per ndertimin e linjave te tensionit te larte dhe te ulet, vepra arti, ura, rruge, vepra social-kulturore, pallate banimi, rikonstruksione objektesh ne veprat bonifikuese, ujesjellesa, kanalizime, vepra hidroteknike te te gjithë llojeve, prodhimin dhe tregtimin e materialeve te ndertimit, ne sferen e tregtimit te mallrave te ndryshme te importit dhe te eksportit me pakice dhe me



12.07.1998

shumice, mallra te tilla si ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, fruta, perime, bime medicinale e pajisje mjekesore, te bar bufe-restorantit, elektro shtepiake, per shfrytezimin dhe tregetimin e lendes drusore, per tregetimin dhe transportimin e karburanteve dhe te vajrave lubrifikante te te gjitha llojeve, kerkim-zbulimin, shfrytezimin dhe importimin e mineralit te kromit dhe produkteve te tij, mermereve, te mallrave te ndryshme etj.

#### NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise.

#### KAPITALI THEMELTAR

#### NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte vene nga ortaku i vetem i shoqerise.

Kapitali mund te shtohet me deshiren dhe sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise, shtese qe mund te behen ne vlere ose ne natyre.

Kapitali mund te transferohet ose te lihet peng sipas dispozitive ne fuqi. Ai mund te transferohet ne rruge trashigimie, bashkeshorti, paraardhesit ose pasardhesit mund te behen ortake te shoqerise nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar.

#### NENI 7

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te ketij statuti si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykatën e rrethit Tiranes, si person juridik ne rregjistrin e saj tregtar, ndersa e ushtron aktivitetin e saj ekonomik tregtar privat me rregjistrimin e saj ne organin tatimor te pushtetit.

#### NENI 8

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje Sh.P.K."Andi Konstruksion" Tirane (Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar).

Te drejten e perdorimit te vules e ka ortaku i vetem i shoqerise si dhe personat e autorizuar prej 12.07.1996

**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI****NENI 9**

Shoqeria "Andi Konstruksion" Tirane eshte prone e ortakut te vetem te shoqerise, themeluesit te saj zotit Latif Miho, i cili qeveris veprimtarine ekonomike te saj, duke u mbeshtetur ne te drejten e pronesise private dhe te mjeteve te investuara ne shoqeri.

Administratori i shoqerise do te jete zoti Latif Miho.

**NENI 10**

Shoqeria merr persiper te drejta dhe detyrimet, kjo vepron me te drejten e saj te pronesise private. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore, brenda kapitalit te saj, ortaku i vetem i shoqerise ka te mbartur rrezikun per veprimtarine ekonomike te shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne kapitalin e shoqerise.

**NENI 11**

Ortaku i vetem i shoqerise ne baze te vendimeve qe merr emerom administratore dhe puneson punonjes te aktiviteteve te ndryshme qe i nevojiten shoqerise.

**NENI 12**

Ortaku i vetem i shoqerise dhe administratoret e emeruar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim dhe kufizim, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te vetem te shoqerise.

Administratoret e emeruar mund te kryejne veprime ne emer te shoqerise, ne marredhenie me te tretet administratoret veprojne ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat. Ata kane te drejte qe te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve te fitimit te shoqerise.

Administratoret kane te drejte qe te kryejne veprime prane te gjitha zyrave shteterore dhe private, qe kane te bejne me garancite dhe veprimet bankare.

Ne te tilla raste administratori i emeruar (autorizuar) eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te jape llogari perpara ortakut te vetem te shoqerise.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e

12. 07. 1998



administratoreve te shoqerise dhe kur keto akte nuk pefshiheshin ne objektin e shoqerise. Ajo merr persiper pasojat ndaj te treteve edhe kur keta te fundit e dinin se akti i administrimit e kalonte objektin e shoqerise, ose kur te tretet nuk mund t'ja injoronin kete akt ne rrethanat e dhena.

## MARREDHENIET E PUNES

### NENI 13

Marredheniet e punes rregullohen me kontraten e punes, qe lidhet ndermjet shoqerise dhe personit te punesuar prane kesaj shoqerie. Mosmarreveshjet e lindura ndermjet paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen per zgjidhje organit kompetente te percaktuar ne kontraten e punes.

### NENI 14

Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore , kurse te punesuarit jane te detyruar qe te pranojne dhe te zbatojne rregullat e ketij statuti. Administratori i emeruar (autorizuar) nuk mund te marre cilesine e ortakut te shoqerise dhe as te ushtroje aktivitet kontraktor te cfaredo lloji per llogari te tij ose te te treteve. Per cdo shkelje ne kete drejtim ai pergjigjet sipas dispozitave ne fuqi. Te gjitha te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes. Sekret pune paraqesin shkresat materiale, te dhenat informative, si dhe vendimet e nxjerra nga ortakut i vetem i shoqerise, qe u jepen organeve shteterore perkatese te miratuara dhe te nenshkruara nga ortakut i vetem i shoqerise;

### NENI 15

Perfaqesimi i shoqerise "Andi Konstruksion" Sh.P.K. Tirane i perket ortakut te vetem te shoqerise, qe eshte njekohesisht edhe administratori i saj zoti Latif Miho, si dhe personave te autorizuar prej tij. Ata kane te drejte qe te perfaqesojne shoqerine edhe ne organet gjyqesore dhe ne gjykime, te caktojne dhe te pushojne avokate per ceshtje ne gjykim.

### NENI 16

Gjithe veprimtaria ekonomike e shoqerise drejtohet nga ortakut i vetem i saj zoti Latif Miho, i cili qeveris gjithe aktivitetin e saj. Ai vendos per pjesemarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera

12. 07. 1996



brenda dhe jashte vendit, ( vendase ose te huaja), te ndryshoje dhe te plotesoje statutin e shoqerise, te miratoje bilancet vjetore dhe periodike te shoqerise te vleresuara nga organi i saj financiar, te vendose per shperberjen e shoqerise, te percaktoje politiken ekonomike te shoqerise, pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, per shtimin ose pakesimin e kapitalit ne vlera ose ne natyre dhe te tjera.

### **EKSPERTI KONTABEL**

#### **NENI 17**

Ortaku i vetem i shoqerise cakton edhe ekspert kontabel, qe te kontrollojne aktivitetin e saj financiar, arken dhe rregjistrin e veprimeve kontabel te shoqerise, si dhe te pergatise raportin perkates.

### **BILANCI DHE TE ARDHURAT**

#### **NENI 18**

Shoqeria "Andi Konstruksion" Sh.P.K. Tirane, cel llogarine e saj rrjedhese ne nje banke shqiptare. Veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen ne fund te cdo viti, me date 31 dhjetor. Ne fund te cdo periudhe nxirret bilanci kontabel qe miratohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te nevojshme i mbeten ortakut te vetem te shoqerise, e cila nbahet per zgjerimin e kapitalit te shoqerise, fondeve te shoqerise dhe ortakut te vetem te saj.

### **CMIMET**

#### **NENI 19**

Aktivitetin e saj shoqeria do t'a zhvilloj kundrejt cmimeve sipas kerkeses dhe ofertes, me perjshtim te cmimeve te vendosura nga qeveria.

### **SHPERBERJA E SHOQERISE**

#### **NENI 20**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cdo shkak, si humbje kapitali, pamundesi veprimtarie, ose me vendim te ortakut te vetem te shoqerise. Ne kete rast ai percakton menytrat e likuidimit te shoqerise dhe percakton nje ose me shume likuidatore.



12. 07. 1996

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

## NENI 21

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje ortakut i vetem i shoqerise si dhe me ligje te vecanta.

Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut do te behen ne te njejten menyre dhe procedure ne te cilen nxirret statuti.

Statuti nenshkruhet rregullisht nga ortakut i vetem i shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SH.P.K."ANDI KONSTRUKSION"  
LATIF MIHO

*Latif Miho*  
*Latif*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR.REP. 1540  
NR.KOL. 220

V E R T E T I M

Sot, më datë 25 Prill 1996 (nëntëdhjetë e gjashtë) ditë e Enjte, në dhomën e Noterisë në Tiranë, para meje noteres, u paraqit personalisht Latif Miho, biri i Hidrit, lindur më 18 shkurt 1964, me dhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identiteti i të cilit mu bë i njohur në bazë të letërnjoftimit të tij personal me Nr. AZ 357345, i cili deklaroj se Statutin e shoqërisë "Andi Konstruksion" shpk e herton me vullnetin e tij të lirë dhe sipas ligjit e nënshkroi atë para meje noteres.

N O T E R E

12. 07. 1996

NOTERË  
LIDA KOKUSHTA  
TIRANË ALBANIA  
TEL 295 49



*Latif*